



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:002682

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05826733

C.nr.1635/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh.D-K dhe D.K që të dy nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, A.D nga fshati Krushë e Madhe , Komuna e Rahovecit dhe A.K nga fshati Hoqë e Vogël, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson avokati S.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokat B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1.000.00 euro, jashtë seancës, me datë 14.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: Sh.D-K, D.K, A.D dhe A.K.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Sh.D-K nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.08.2022, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421euro) x 27% (minusuar 58,32 euro në listën e pagave nga shuma 113,67 euro) = 55,35 euro x 6 muaj, t’ia paguaj shumën prej 332.1 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 28.12.2023(data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit D.K nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 01.08.2022, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58,32 euro në listën e pagave nga shuma 113,67 euro) = 55,35 euro x 6 muaj, t’ia paguaj shumën prej 332.1 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 28.12.2023(data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.D nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit të diferencës së

pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2022, e deri me datën 31.01.2023, për 35% të pagës bazë (393euro) x 35% (minusuar 54,45 euro në listën e pagave nga shuma 137,55 euro) = 83.1 euro x 13 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1080.3 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 28.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.K nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 01.07.2022, e deri me datën 31.01.2022, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 7 muaj, t'ia paguaj shumën prej 387.45 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 28.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

VI. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses Sh.D-K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 332.1 euro e deri në shumën prej 635.22 euro dhe atë për shumën prej 303.12 euro.

VII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit D.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 332.1 euro e deri në shumën prej 635.22 euro dhe atë për shumën prej 303.12 euro.

VIII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses A.D për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 1080.3 euro e deri në shumën prej 1.284.66 euro dhe atë për shumën prej 204.36 euro.

IX. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit A.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 387.45 euro e deri në shumën prej 741.09 euro dhe atë për shumën prej 353.64 euro.

X. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve Sh.D-K, D.K, A.D dhe A.K, t'ia paguajë shumën prej 280.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Sh.D-K, D.K, A.D dhe A.K, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar S.M nga Prizreni, më datën 28.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1.000.00 euro.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se paditësit Sh.D-K dhe D.K janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.F.M.U. “Vëllezërit Frashëri” në fshatin Drenoc, komuna e Rahovecit, ndërsa paditësit A.D dhe A.K janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.F.M.U. “Heronjtë e Kosovës” në fshatin Hoçë e Vogël, komuna e Rahovecit. Paditësve me vendimin Nr.01/33 të dt.29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.20023, ju takon e drejta e kompensimit për 27-39% t si nën pikën 3) dhe 35-47% si nën pikën 4), andaj paditësve ju takon e drejta e kompensimit për licencim. Baza ligjore për realizimin e kompensimit në emër të licencimit është Vendimi nr.01/33 i dt.29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës (bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të dt.09.10.2023) , ndërsa bazë tjetër ligjore janë edhe neni 8 par.1, neni 245 parr.1,24 të LMD-së, neni 55 dhe 90 i Ligjit të punës. Andaj i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 10.05.2024, ku ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që Ministria e Arsimit si palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk ka ndarë mjetet financiare të nevojshme për Komunën e Rahovecit. Paditësit kanë kërkuar kompensimin e pagave për 27% të vlerës së pagës bazë, lidhur me këtë e paditura konsideron se kjo kërkesë është e pabazë, për shkak se dispozita e nenit 7 të KKAK-së nuk ka përcaktuar se duhet të kompensohet dhe nëse duhet të kompensohet nga punëdhënësi i fundit apo se kush duhet të paguajë kompensimit në bazë të kualifikimit. Paditësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkuar.

Enjajta ka theksuar se: Paditësi D.K, ka parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të licencimit, për periudhën kohore 01.01.2021-31.01.2023, e evidentuar pranë kësaj gjykate me nr. C.nr.1141/2023, me numër të lëndës 2023:252018, dhe padinë tjetër për kompensim në emër të kualifikimit për periudhën kohore nga 01.01.2022-31.01.2023, e evidentuar me numër C.nr.63/2024, me numër të lëndës 2024:012149.

Paditësi A.K, ka parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të licencimit, për periudhën kohore 01.01.2021-31.01.2023, e evidentuar pranë kësaj gjykate me nr. C.nr.1250/2023, me numër të lëndës 2023:263030.

Paditësja Sh.D-K dhe paditësi D.K, kanë parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të kualifikimit, të evidentuar pranë kësaj gjykate me numër C.nr.638/2021, ndërsa D.K ka parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të kualifikimit e evidentuar me numër C.nr.652/2021 me numër të lëndës 2021:152914.

Paditësit A.D dhe A.K, kanë parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të kualifikimit, të evidentuar pranë kësaj gjykate me numër C.nr.650/2021.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 66/05 e datës 01.10.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses Sh.D; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 78/05 e datës 01.09.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit D.K; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1180/I e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, paditëses Afërdita Duraku; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1201/I e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.K; diplomën Nr. 1088 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prizren, e paditëses Sh.D; diplomën Nr. 71 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, i paditësit D.K; Diplomën Nr.1422/20 e lëshuar nga Kolegji AAB, e paditëses Afërdita Duraku; diplomën Nr. 357 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, i paditësit A.K; licenca e mësimdhënës nr.100022755 e paditëses Sh.D; licenca e mësimdhënës nr.100008689 e paditësit D.K; licenca e mësimdhënës nr.1008689 e paditësit D.K; licenca e mësimdhënës nr.100009482 e paditëses Afërdita Duraku; licenca e mësimdhënës nr.1009356 e paditësit A.K si dhe listat e pagës të muajit maj 2021.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit posedojnë licenca. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe licencimit, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 66/05 e datës 01.10.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses Sh.D-K, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 78/05 e datës 01.09.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe

paditësit D.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 1180/I e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses Afërdita Duraku, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1201/I e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël.

Me administrimin e diplomës Nr.1088 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prizren, e paditëses Sh.D, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Sh.D ka përfunduar studimet më 11.07.2014 dhe mori titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze.

Me administrimin e diplomës Nr. 71 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, e paditësit D.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D.K ka përfunduar studimet më 06.10.2008 dhe mori titullin Bachelor i Kimisë-Fizikës.

Me administrimin e diplomës Nr.1422/20, e lëshuar nga Kolegji AAB, i paditëses Afërdita Duraku, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.D ka përfunduar studimet në nivelin master dhe mori titullin Master i Arteve në Politika Sociale dhe Mirëqenia e Fëmijëve.

Me administrimin e diplomës Nr.357, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, i paditësit A.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K ka përfunduar studimet më 01.07.2015 dhe mori titullin Bachelor i Gjeografisë-Edukatë Qytetare.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr.100022755, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Sh.D është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100008689, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D.K është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1008689, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D.K është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr.100009482, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.D është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1009356, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Sh.D-K ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D.K ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.D ka pasur pagën bazë 393,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë së paditësve për shkak se në bazë të Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës. Në këtë rast paditësit Sh.D-K, D.K dhe A.K, në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedojnë diplomë universitare i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 27%, ndërsa paditësja Afërdita Duraku, në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedonë diplomë të nivelit Master i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 35% .

Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve Sh.D-K, D.K dhe A.K, ua ka paguar shumën prej 58,32 euro, ndërsa paditëses A.D në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, i ka paguar shumën prej 54,45 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. II. III. IV. V. VI. VII. të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parashihet *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Sa i përket pretendimeve të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësi D.K është kompensuar në emër të licencimit, për periudhën kohore 01.01.2021-31.01.2023, e evidentuar me numër C.nr.1141/2023 me numër të lëndës 2023:252018, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që gjykata ka verifikuar faktin që paditësi nuk është personi i njëjtë siç pretendon e paditura, paditësi që është kompensuar është D.K nga fshati Krushë e Madhe, me nr. personal:1016033878, po ashtu sa i përket pretendimeve për padinë tjetër me numër të lëndës C.nr.63/2024, me numër të lëndës 2024:012149, gjykata ka verifikuar faktin që paditësi D.K nuk është personi i njëjtë pasi që i njëjti është nga fshati Hoçë e Vogël, dhe është i punësuar në SH.F.M.U “Heronjtë e Kosovës”.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se paditësi ka parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të kualifikimit pranë kësaj gjykate me numër të lëndës C.nr.1250/2023 me numër të lëndës 2023:263030, gjykata i vlerëson si pretendime të pabazuara, pasi që gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nuk është kompensuar emër të kualifikimit, pasi që nuk është i njëjti person, paditësi A.K i cili është kompensuar është nga fshati Senoc dhe i njëjti punon në SH.F.M.U “Milaim Krasniqi” në Pastasellë.

Sa i përket pretendimeve të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit D.K dhe Sh.D K kanë parashtruar padi në emër të licencimit, e evidentuar me numër C.nr.638/2021 , edhe këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që gjykata ka verifikuar faktin janë kompensuar për një periudhë tjetër, ndërsa padia tjetër me numër C.nr.652/2021, me numër të lëndës 2021:152914, paditësi D.K, nuk është i njëjti person.

Po ashtu, sa i përket pretendimeve të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.D dhe D.K kanë parashtruar padi në emër të licencimit, e evidentuar me numër C.nr.650/2021 , edhe këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që gjykata ka verifikuar janë kompensuar për periudha tjera.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë në pjesën tjetër në shumën prej 303.12 euro për paditësen Sh.D-K, shumën prej 303.12 euro për paditësin D.K, shumën prej 204.36 euro për paditësen A.D si dhe shumën prej 353.64 për paditësin A.K, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në bazë të Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008. bazuar në pikën 4, paditësit përfitojnë ngritje në bazë të pagës bazë, parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në rastin konkret paditësit Sh.D- Krasniqi, D.K dhe A.K posedojne Diplomë Universitare ku përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, ndërsa paditësja A.D posedonë diplomë të nivelit Master, prandaj përfitonë ngritje në bazë të pagës bazë prej 35%., e jo sipas pikës 6 të Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që në emër të kualifikimit bachelor iu takojnë 27%-39% dhe për Master 35%-47, pasi që pika 6, e këtij vendimi fletë për përqindja më e ulët dhe më e lartë e rritjes për secilën kategori dhe nivel të mësimdhënësve (fillor dhe të mesëm) sipas kualifikimit dhe përvojës së punës, andaj gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me kërkesa për kualifikim që përfshin pika 4, e vendimit në fjalë, sepse paditësit sipas listës së pagave janë kompensuar për përvojën e tyre.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve

në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parashihet *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit është *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe pretendimet e të paditurës se kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar nuk qëndrojnë, pasi që padia është parashtruar me datë 28.12.2023, brenda afatit kohorë.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi në tërësi pasi që është e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”,* ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë të paditësit shumën si në pikën VIII të dispozitivit të

këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 280.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 260.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 20.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1635/2023, më datë 14.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.